

VENDIM
Nr. 466, datë 26.7.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 312, DATË 11.5.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT TË *STARTUP*-eve DHE LEHTËSUESVE, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE NDËRLIDHJEN E TIJ ME PORTALIN QEVERTAR ‘E-*ALBANIA*’, SI DHE PËR DOKUMENTET ELEKTRONIKE – PASAPORTA E *STARTUP*-eve DHE PASAPORTA E LEHTËSUESVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit nr. 312, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, fjalët “...ministri përgjegjës për sipërmarrjen...” zëvendësohen me togfjalëshin “*Startup Albania*”.
2. Ngarkohen “*Startup Albania*” dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku